

Nënshkruhen
marrëveshjet në vlerë
96 milionë euro me
Bankën Botërore



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

HARADINAJ, AKUZA PËR QEVERINË KURTI: KOSOVA PO KEQQEVERISET

FAQE 4-5



Kryetari i Aleancës për
Ardhmërinë e Kosovës, Ramush
Haradinaj, ka thënë të hënën se
Kosova po qeveriset nga Albin
Kurti në kundërshtim me krejt

normat ligjore dhe kushtetuese.
Ai ka thënë se sot është koha që
qytetarët ta marrin fatin në
duart e veta përmes votës. "Këtë
gjendje të rënduar mund ta

ndryshojë vetëm sovrani duke i
ndëshkuar fajtorët për gjendjen.
Kosova nuk është e varfër, por e
keqkëqeverisur", ka thënë
Haradinaj

AKTUALE



**EKSPERTËT PARALAJMËROJNË:
PËRDORIMI I KOKAINËS
NË KOSOVË PO DEL JASHTË
KONTROLLIT** F. 6

**DALLAVERE ME PATENTË
SHOFERË, PROKURORIA
SEKUESTRON PROVA DHE
ARRESTON KATËR PERSONA** F. 5

**FSK-ja, PJESË E USHTRIMIT
NDËRKOMBËTAR "MITTELMARK
2026" NË GJERMANI** F. 3

EKONOMI



**SHAHINI: MBI 50 % JASHTË
TREGUT TË PUNËS NË KOSOVË,
POLITIKAT SHTETËRORE
PO E ÇOJNË EKONOMINË
DREJT STAGNIMIT** F. 8

**ASK-ja: SHKALLA E PAPUNËSISË
NË VITIN 2024 ISHTE 13.9 %** F. 8

SPORT



**FODA PARA NDESHJES
ME SLOVAKINË: MUND
TA SHKRUAJMË HISTORINË** F. 11



**KEQLLOGARITJA
QË MUND TA
DESTABILIZOJË
BALLKANIN** F. 3



**TRUMPI: SHBA-ja DO T'I
NDALË SULMET NDAJ
CAQEVË ENERGJETIKE TË
IRANIT PAS BISEDIMEVE
"SHUMË TË MIRA"
ME TEHERANIN** F. 2

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI: SHBA-JA DO T’I NDALË SULMET NDAJ CAQEVE ENERGJETIKE TË IRANIT PAS BISEDIMEVE “SHUMË TË MIRA” ME TEHERANIN

UASHINGTON, 23 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë të hënën se Uashingtoni dhe Irani kanë zhvilluar “biseda frytdhënëse” për ta zgjidhur përfundimisht konfliktin në Lindjen e Mesme. Ai theksoi se do t’i “pezullojë të gjitha sulmet ndaj centraleve energjetike dhe infrastrukturës energjetike iraniane” për një periudhë pesëditore. Bisedimet me Iranin do të vazhdojnë gjatë gjithë javës, tha Trumpi në rrjetet sociale. “E kam udhëzuar Departamentin e Luftës që t’i pezullojë të gjitha sulmet ushtarake ndaj centraleve energjetike dhe infrastrukturës energjetike iraniane për një periudhë pesëditore në varësi të suksesit të takimeve dhe diskutimeve në vazhdim”, shkroi ai. Nuk ka pasur asnjë njoftim se po zhvilloheshin bisedime në mes të Uashingtonit dhe Teheranit e as nuk janë dhënë hollësi për bisedimet e fundjavës që përmendi presidenti. Agjencia e lajmeve “Fars”, e cila është e afërt me Trupat e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), citoi burime duke thënë: “nuk ka komunikim të drejtpërdrejtë me Trumpin e as përmes ndërmjetësve”. Ndërkohë Izraeli, i cili reagoi pas njoftimit të Trumpit se po kryente sulme ajrore në Iranin qendror, nuk ka komentuar publikisht.

Afati për Ngushticën e Hormuzit

Të shtunën Trumpi e kishte paralajmëruar Iranin se centralët e tij elektrike do të shkatërroheshin nëse Teherani nuk do ta “hapte plotësisht” Ngushticën e Hormuzit për të

gjithë transportin detar brenda 48 orësh. Trumpi e caktoi afatin deri të hënën rreth mesnatës. Paralajmërimi i tij nxiti kërcënime për kundërpërgjigje nga Garda Revolucionare e Iranit, e cila në një deklaratë të hënën tha se do t’i sulmojë centralët elektrike të Izraelit dhe ato që i furnizojnë bazat amerikane në rajonin e Gjirit nëse Trumpi do ta zbatojë kërcënimin për ta “shkatërruar plotësisht” rrjetin energjetik të Iranit. Ndërsa Mohammad Baqer Qalibaf, kryetar i Parlamentit iranian, paralajmëroi se “menjëherë pas shënjestrimit të centraleve elektrike dhe infrastrukturës në vendin tonë, infrastruktura jetike, si dhe infrastruktura energjetike dhe e naftës në të gjithë rajonin, do të konsiderohen objektiva legjitime dhe do të shkatërrohen përherë”. Më shumë se 3 000 njerëz janë vrarë në luftën që ShBA-ja dhe Izraeli e nisën më 28 shkurt, sipas grupit iranian për të drejtat e njeriut, HRANA. Lufta ka tronditur tregjet, ka rritur kostot e karburantit, ka nxitur frikë për inflacion global dhe ka lëkundur aleancën perëndimore të pasluftës. Kërcënimi për sulme ndaj rrjeteve elektrike në Gjirin Persik ka rritur frikën për ndërprerje të mëdha në procesin e shkripëzimit të ujit për pije dhe ka trazuar edhe më shumë tregjet e naftës.

Izraeli paralajmëron luftë të gjatë kundër Iranit dhe Hezbollahut

Jerusalem, 23 mars - Teksa po afrohet afati i fundit i vendosur



nga presidenti amerikan, Donald Trump, që Irani ta hapë Ngushticën e Hormuzit, ushtria izraelite i ka paralajmëruar shtetasit e vet për “më shumë javë” luftë kundër Iranit dhe Hezbollahut - grupit të shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi të tjera. “Shtetas të Izraelit, ne përballemi me më shumë javë luftime kundër Iranit dhe Hezbollahut”, ka thënë zëdhënësi i ushtrisë izraelite, Effie Defrin, në disa deklarime televizive më 22 mars. “Çdo ditë që kalon ne jemi më afër dobësimit të regjimit terrorist [në Teheran]. Ne nuk do të lejojmë atë apo degëzimet e tij t’i kërcënojnë qytetarët tanë të Izraelit, apo ekzistencën e shtetit të Izraelit”, ka thënë Defrin, duke shtuar se fushata tokësore kundër Hezbollahut në Liban do të shtohet në javët në vijim. “Operacioni kundër organizatës terroriste të Hezbollahut tashmë ka nisur... ky është operacion më i gjatë”, ka thënë

gjenerallejtënant Eyal Zamir përmes një deklarate.

Ultimatumi i Trumpit për Hormuzin

Deklaratat nga Izraeli janë disi të kundërta në krahasim me palën amerikane për kohëzgjatjen e luftës. Të gjithë sytë tani janë te një ultimatum i Trumpit, i vendosur më 21 mars në orën 19:44 me kohën e Uashingtonit, kur presidenti i ka kërkuar Teheranit “hapjen e plotë” të Ngushticës së Hormuzit brenda 48 orësh ose në të kundërtën do të përballlet me pasoja të rënda - një përshkallëzim i madh i tensioneve në luftën që tashmë rrezikon të dalë jashtë kontrollit. “Nëse Irani nuk e hap plotësisht, pa kërcënime, Ngushticën e Hormuzit brenda 48 orësh nga ky moment, Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t’i godasin dhe zhdukin centralët e energjisë, duke nisur me më të madhin!”, ka thënë Trumpi në platformën “Truth Social”. Ai nuk ka përmendur se cilat centrale të energjisë do të shënjestrohen, mirëpo deklarata e tij vjen një ditë pasi ai ka thënë se e konsideron uljen e intensitetit të operacioneve luftarake meqë, sipas tij, shumica e synimeve amerikane janë arritur. Pentagoni gjithashtu raportohet se po dërgon mijëra trupa shtesë tokësore në rajon. Irani, në anën tjetër, është zotuar se do të hakmerret nëse Trumpi e jetëson kërcënimin e tij me sulme në centralët bërthamore. Komanda ushtarake e Iranit është cituar të ketë thënë, sipas medias shtetërore, se nëse sulmohet infrastruktura e energjisë e Iranit, e gjithë infrastruktura e energjisë që i përket ShBA-së në rajon do të

sulmohet gjithashtu. Sulme të tilla hakmarrëse iraniane do të kishin efekte shkatërruese në shtetet e Gjirit Arab të cilat janë konsumatore të mëdha të energjisë. Garda Revolucionare Islamike e Iranit ka kërcënuar me mbyllje të plotë të Ngushticës së Hormuzit, duke shtuar se ajo mund të rihapet vetëm kur të rindërtohen objektet e shkatërruara nga sulmet amerikane. Bllokada në ngushticë i ka rritur çmimet globale të naftës dhe më pas i ka rritur edhe çmimet e produkteve të tjera të domosdoshme. Sulmet iraniane në objektet e naftës dhe gazit në rajonin e Gjirit i kanë rritur shqetësimet për më shumë rritje çmimesh.

Rutte: Kombet po përgatiten për detyrë në ngushticë

Trumpi u ka kërkuar shteteve që e shfrytëzojnë Ngushticën e Hormuzit për të transportuar burime të energjisë, që ta sigurojnë transportin në atë zonë. Ai është shprehur edhe i zemëruar pse shumë shtete kanë hezituar t’i angazhojnë ushtritë e tyre. Mirëpo më 22 mars, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë se mbi 20 shtete janë duke planifikuar të përfshihen në rihapjen e ngushticës. “E di që presidenti ka qenë i zemëruar për shkak se ndihet sikur aleatët evropianë dhe aleatët e tjerë kanë qenë shumë të ngadalshëm”, ka thënë Rutte për Fox News më 22 mars. Ai ka shtuar se NATO-ja po synon të punojë në këtë drejtim me Japoninë, Korenë e Jugut, Australinë, Zelandën e Re, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahrejnin.



Nënshkruhen marrëveshjet në vlerë 96 milionë euro me Bankën Botërore

PRISHTINË, 23 MARS - Ministria e Financave dhe Banka Botërore kanë nënshkruar dy marrëveshje në vlerë totale prej 96 milionë eurosh me qëllim forcimin e sektorit financiar dhe lehtësimin e tregtisë në Kosovë. Marrëveshjet përfshijnë Projektin për Zhvillimin e Sektorit Financiar (FSDP) me vlerë prej 50 milionë eurosh si dhe Projektin për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0 (TTFP 2.0) i cili përbëhet nga kredi prej 35 milionë eurosh dhe grant prej 12 milionë eurosh. Këto projekte synojnë të mbështesin reforma strukturore dhe investime strategjike në

përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Projekti për Zhvillimin e Sektorit Financiar do të mbështesë themelimin dhe funksionalizimin e Bankës Zhvillimore, kapitalizimin e institucioneve kyçe financiare, zgjerimin e instrumenteve të garancisë kreditore për bizneset si dhe zhvillimin e infrastrukturës moderne të pagesave përmes sistemit të pagesave të shpejta. Ndërkaq Projekti për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit synon përmirësimin e infrastrukturës dhe procedurave në pikat kufitare, digjitalizimin e proceseve

tregtare dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tregut, duke e afruar edhe më tej vendin me rrjetet dhe standardet evropiane. Ministri i Financave, Hekuran Murati, theksoi se këto marrëveshje përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt forcimit të stabilitetit financiar dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Ato përmirësojnë qasjen në financa për bizneset dhe rrisin efikasitetin e tregtisë, duke kontribuar drejtpërdrejt në modernizimin e ekonomisë sonë. Ndërkaq Xiaoqing Yu, përfaqësuese e Bankës Botërore, falënderoi ministrin



Murati për bashkëpunimin efektiv, shprehu optimizëm për zbatimin në kohë të projekteve dhe riafirmoi angazhimin e Bankës Botërore për thellimin e bashkëpunimit në nismat e ardhshme.

Këto marrëveshje përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të ekonomisë, lehtësimin e aktivitetit tregtar dhe përsheptimit të integritetit ekonomik të Kosovës në rajon dhe më gjerë.

HARADINAJ, AKUZA PËR QEVERINË KURTI: KOSOVA PO KEQQEVERISET

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të hënën se Kosova po qeveriset nga Albin Kurti në kundërshtim me krejt normat ligjore dhe kushtetuese. Ai ka thënë se sot është koha që qytetarët ta marrin fatin në duart e veta përmes votës. “Këtë gjendje të rënduar mund ta ndryshojë vetëm sovrani duke i ndëshkuar fajtorët për gjendjen. Kosova nuk është e varfër, por e keqqeverisur”, ka thënë Haradinaj

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 MARS - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar në lidhje me situatën e krijuar politike në vend. Ai ka thënë se është e dhimbshme kur jonormaliteti shndërrohet në mënyrë jetese, e kur vendi qeveriset për një vit të tërë në kundërshtim me krejt normat ligjore e kushtetuese. “Kur bëhemi vendi i vetëm me parlament të zgjedhur, por të pezulluar. Kur temat politike bëhen kryefjalë e debatit publik dhe qitet në harresë jeta e njeriut të zakonshëm. Atij njeriu i cili detyrohet të gjejë strehë ekzistence nëpër botë e atje të kryejë punë të rënda, që jo rrallë i kushtojnë edhe me jetë, siç ishte rasti i tre qytetarëve fatkeq që humbën jetën në një vendpunishte në Vjenë. Më nuk po flasim për

vargun e njerëzve që po e braktisin Kosovën. Për ata që nuk e lidhin fillimin me fundin e muajit. Që tryezën e kanë përditë e më të varfër. Për pushtetin që e shtrenjton rrymën sa herë që i teket. Për zhgënjimin e prindërve me sistemin shkollor të fëmijëve të tyre. Për të sëmurët që shërimin e kanë të papërbalueshëm”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”. Ai ka thënë se është e dhimbshme se si ndihmat prej 100 eurosh në prag të zgjedhjeve, që nuk janë më shumë sesa lëmoshë, po shndërrohen në mrekullinë e “çudibërësit”. “Si ndodhi që u zhdukën nga fjalori e preokupimi ynë investimet kapitale apo investimet e huaja? U harruan qindra tenderë njëburimorë, apo projektet e filluara vite më parë e që nuk po përfundojnë. Ata që nuk janë të zotët të kryejnë punë, zakonisht



arsyetohen se Kosova nuk është Zvicër as Gjermani, por sa iu përket çmimeve, shpeshherë jemi më Zvicër e Gjermani sesa ato vetë”, është shprehur Haradinaj. Ai ka shtuar se “jemi i vetmi vend që brenda një viti mbajmë katër palë zgjedhje dhe e bllokojnë zgjidhjen e na çojnë prapë në zgjedhje”. “Një parti politike e vetme, veç për propagandë, shpenzon mbi 4

milione euro për zgjedhje e shumë miliona të tjerë nga ata që janë të obliguar t'i organizojnë zgjedhjet, të gjitha këto para të taksapaguesve. Në gjithë këtë periudhë kohe të jonormalitetit politik e institucional, viktima e vetme ka qenë qytetari i Kosovës. Ai është varfëruar, ai është përballur me sfidën e mbijetesës, ai ka emigruar... Prandaj sot është koha që ai ta

marrë fatin në duart e veta. Këtë gjendje të rënduar mund ta ndryshojë vetëm sovrani dhe vetëm duke i ndëshkuar fajtorët për gjendjen. Kosova nuk është e varfër, por e keqqeverisur. Mund të sigurohet e ardhmja e sigurt jo vetëm për ne që jetojmë këtu, por edhe për ata qindra mijëra qytetarë që sot janë në diasporë. Unë kam shpresë për ditë më të mira!”, ka theksuar Haradinaj.

FSK-ja, pjesë e ushtrimit ndërkombëtar “Mittelmark 2026” në Gjermani

PRISHTINË, 23 MARS - Forca e Sigurisë së Kosovës u është bashkuar shteteve partnere në ushtrimin ndërkombëtar “Mittelmark 2026” i cili po realizohet në Gjermani. Në këtë ushtrim FSK-ja, me një skuadër transporti nga Komanda e Logjistikës, po realizon operacione duke

qenë e integruar në strukturat e ushtrisë gjermane. Ky ushtrim ka në fokus zhvillimin e kapaciteteve në fushën e transportit dhe mbështetjes logjistike në klasat I, III dhe V. FSK-ja po operon me automjetet e saj logjistike, duke qenë plotësisht e

integruar në strukturat e ushtrisë gjermane. Përmes këtij ushtrimi pjesëtarët e Komandës së Logjistikës po realizojnë me sukses detyra të mbështetjes në transport, duke dëshmuar profesionalizëm dhe ndërveprueshmëri në mjedis ndërkombëtar.





KEQLLOGARITJA QË MUND TA DESTABILIZOJË BALLKANIN

PRISHTINË, 23 MARS - Gara në armatim ekziston prej shekujsh, por pas Luftës së Dytë Botërore mori formë globale dhe sistematike, sidomos midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë.

Armët bërthamore, raketat balistike dhe avionët luftarakë transformuan mënyrën e konceptimit të fuqisë në vitet që pasuan.

Sot në rajonin e Ballkanit Perëndimor lëvizjet e Serbisë dërgojnë paralajmërime serioze.

Ky vend - partner i NATO-s dhe kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian - bleu raketa balistike supersonike nga Kina për forcën ajrore. Kështu u bë fuqia e parë në Evropë e pajisur me raketat ajër-tokë CM-400AKG, sipas presidentit serb, Aleksandar Vuçiq. “E kemi bërë me sukses integrimin e raketave kineze në avionët rusë MiG-29 të gjeneratës së katërt. Këta janë sot ndër avionët më të mirë në Evropë, ndoshta edhe në botë. Raketat ajër-tokë nënkuptojnë goditjen e objektivave në tokë dhe kanë fuqi shkatërruese”, tha Vuçiqi më 12 mars.

Reagimet ishin të shumta nga fqinjët që luftuan kundër Serbisë gjatë luftërave jugosllave të viteve 1990.

Kroacia - sot anëtare e NATO-s dhe Bashkimit Evropian - e konsideroi blerjen e raketave kineze si kërcënim për stabilitetin rajonal dhe shenjë të rritjes së garës së armatimit në Ballkan, ndërsa Kosova akuzoi Serbinë për tendencë hegjemoniste ndaj fqinjëve.

Këto dy vende, së bashku me Shqipërinë, nënshkruan në mars të vitit 2025 një marrëveshje për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të cilën Vuçiqi e sheh si kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e Serbisë - “nuk ekziston asnjë arsye tjetër për bashkimin e tyre, vetëm Serbia”. “Ne po përgatitemi për sulmin e tyre. Ata nuk synojnë të mbrohen, por të sulmojnë. Po formojnë aleancë ushtarake për të na sulmuar”, tha Vuçiqi teksa fliste për raketat kineze në Radio-Televizionin e Serbisë.

Ai nuk paraqiti asnjë provë për këto pretendime, të cilat Zagrebi, Prishtina dhe Tirana i hedhin vazhdimisht poshtë. Tha vetëm se forcat e armatosura serbe kanë në dispozicion edhe armë të tjera të sofistikuara që nuk mund të bëhen publike.

Për njohësit e çështjeve ushtarake dhe të sigurisë këto mesazhe dërgojnë sinjale frike dhe pasigurie në rajon, rrisin perceptimin e kërcënimit dhe

shtynjë vendet fqinje drejt forcimit të kapaciteteve mbrojtëse. Kjo dinamikë, sipas tyre, mund të shndërrohet lehtësisht në një spirale të re armatimi, ku çdo veprim prodhon kundërveprim dhe tensionet vetëm rriten.

Redion Qirjazi, ekspert i sigurisë në Shqipëri - vend anëtar i NATO-s, thotë se raketat kineze i japin Serbisë mundësi të reja për ta projektuar fuqinë dhe ndryshojnë balancën e sigurisë në rajon; ato nuk janë thjesht mbrojtje - siç pretendon blerësi - por zgjasin kapacitetet ushtarake në distanca të largëta. “Raketat kineze janë shumë precize. Një veçori shqetësuese e tyre është edhe shpejtësia e lartë - rreth Mach 4 deri Mach 5, ose deri në 6 mijë km/orë - që i fut në kategorinë e raketave të vështira për t’u interceptuar”, thotë Qirjazi për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Në Ballkan Serbia mban tensione të hapura me Kosovën, ndaj së cilës ka pretendime territoriale, me Kroacinë dhe herë pas here me Malin e Zi. Marrëdhëniet e saj me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut janë më të qeta, ndërsa lidhja me Republikën Serpska në Bosnjë-Hercegovinë mbetet një rast i veçantë, që dallon nga pjesa tjetër e këtij shteti.

Blerjet e raketave kineze, sipas Kadri Kastratit, ekspert ushtarak nga Kosova, tregojnë qartë tendencën e Serbisë për t’u pozicionuar si aktori më i armatosur dhe më dominues në Ballkan dhe për ta mbajtur rajonin gjithmonë në tërësi të destabilizimit. “Gjithë këtë armatim, Serbia është duke e blerë për të hyrë në garë, para së gjithash me Kroacinë. Pas furnizimit të Kroacisë me avionët Rafale nga Franca, Vuçiqi bëri marrëveshje me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, për blerjen e avionëve të tillë. Pra, është një garë mes tyre”, thotë Kastrati për Exposenë.

Edhe pse pretendon neutralitet ushtarak, Serbia është ushtria më e shtrenjtë në Ballkanin Perëndimor. Vetëm në vitin 2024 shpenzoi 2.2 miliardë dollarë - rreth pesë herë më shumë se Shqipëria, anëtare e NATO-s dhe vendi i dytë në rajon për shpenzime ushtarake, sipas të dhënave të Institutit të Stokholmit për Kërkime mbi Paqen (SIPRI). Serbia shpenzon dukshëm më shumë edhe se Kroacia, e cila gjithashtu është anëtare e NATO-s. Sipas SIPRI-t, dallimi në shpenzimet e mbrojtjes midis këtyre dy vendeve arrin në qindra miliona euro çdo vit.

Pas pushtimit rus të Ukrainës, Serbia i ndryshoi burimet e saj të

armatimit, duke iu drejtuar Kinës për dronë luftarakë dhe sistemin raketor anti-ajror FK-3, por nuk ndaloi as blerjet nga Perëndimi, si Shtetet e Bashkuara dhe Franca.

Në deklaratat e tij, Vuçiqi i kushton vëmendje të veçantë sidomos forcës ushtarake të Kroacisë. Në vitin 2024, kur Serbia bleu avionë luftarakë shumëfunksionalë, Rafale, nga Franca, ai ironizoi duke thënë se kur Kroacia bën të njëjtën gjë, është “lajm i mirë për rajonin”, ndërsa kur Serbia i blen, bëhet “tragjedi”. “Ne nuk krijojmë probleme askund, as nuk i planifikojmë, as nuk i synojmë. Ky është një sinjal i madh i besimit mes Francës dhe Serbisë. Ne vetëm duam ta ruajmë vendin tonë”, tha Vuçiqi.

Katarina Gjokiq, hulumtuese në Institutin e Stokholmit për Kërkime mbi Paqen, thotë se krahasimet mes Serbisë dhe Kroacisë duhen parë me kujdes. Kroacia, si anëtare e NATO-s, planifikon kapacitetet e saj ushtarake brenda aleancës dhe ndjek detyrat përkatëse, ndërsa Serbia vepron jashtë këtij mekanizmi.

Gjokiqi thotë se ekziston një tendencë e elitave politike që të shikojnë përtej kufirit dhe ta përdorin armatimin e fqinjëve si alibi për të justifikuar zgjerimin e fuqisë së tyre. “Ajo që është

DALLAVERE ME PATENTË SHOFERË, PROKURORIA SEKUESTRON PROVA DHE ARRESTON KATËR PERSONA

PRISHTINË, 23 MARS - Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion, ka njoftuar se me vendim të Prokurorit të Shtetit janë ndaluar për 48 orë katër persona të dyshuar, njëri me inicialet I. M. nga auto shkolla “A.....” për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale “Marrja e ryshfetit” nga neni 421 i KPRK-së, dy persona me inicialet A. B. dhe Z. B. nga auto shkolla “L.....” për shkak të dyshimit të arsyeshëm se e kanë kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar” nga neni 427



i KPRK-së dhe një person me inicialet V. L., ekzaminere për patentë shofer në MMPHI, për shkak të dyshimit të arsyeshëm

se ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 i KPRK-së. Ky arrestim është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me hetuesit policorë nga Policia e Kosovës, Sektori për Hetimin e Korrupsionit në DHKEK në Prishtinë ashtu që, pas zbatimit të masave të veçanta hetimore, të pandehurit I. M. i janë gjetur dhe sekuestruar 800 euro ryshfet të përdorura nga fondi i Policisë së Kosovës, ndërsa në zbatim të urdhër kontrollit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, është realizuar kontrolli në dy autoshollat e cekura më lart ku

janë siguruar provat e nevojshme materiale, ndërsa të pandehurve I. M. dhe V. L. u janë sekuestruar telefonat celularë. Brenda afatit ligjor Prokurori i Shtetit do ta dorëzojë NË Gjykatë kërkesën për caktimin e ndonjë prej masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale. Prokurori i Shtetit mbetet i përkushtuar për luftimin e kriminalitetit dhe korrupsionit si dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për parandalimin e këtyre veprave penale si dhe dërgimin para gjykatës të secilit kryerës të veprave penale.

AAK-ja DORËZON KËRKESË NË MINISTRINË E TREGTISË PËR MARRJEN E MASAVE URGJENTE PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EKONOMIKE

PRISHTINË, 23 MARS - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka dorëzuar kërkesën e kësaj partie në Ministrinë e Tregtisë për marrjen e masave urgjente për përballimin e situatës ekonomike në vend dhe uljen e çmimit të naftës. AAK-ja në këtë kërkesë ka theksuar se rritja e çmimit të naftës po ndikon drejtpërdrejt në të gjithë ekonominë, duke rritur kostot e transportit, prodhimit dhe furnizimit si dhe çmimet e produkteve dhe shërbimeve. “Si pasojë, fuqia blerëse e qytetarëve është në rënie dhe po krijohet një efekt domino që prek bizneset dhe konsumatorët. Mungesa e masave konkrete institucionale në këtë situatë mbetet shqetësuese për stabilitetin ekonomik. Në vend të politikave

lehtësuese, po vërehen qasje që vështirësojnë operimin e bizneseve, ndërkohë që praktikat ndërkombëtare tregojnë nevojën për ulje të barrës fiskale, mbështetje të sektorëve kritikë dhe krijim të rezervave strategjike”, thuhet në kërkesën e AAK-së. Kjo parti ka kërkuar masa të menjëhershme dhe konkrete: 1. Lirimin e menjëhershëm së paku 50 % nga TVSh-ja për derivatet; 2. Heqjen e përkohshme të akcizës për naftën deri në stabilizimin e tregut, që së bashku me TVSh-në do të ndikonte në uljen e çmimit për rreth 40 centë për litër; 3. Krijimin urgjent të një taskforce të përbashkët me Odën Ekonomike, Shoqatën e Naftëtarëve dhe shoqatat e tjera relevante, në bashkëpunim me



MINT-in dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave; 4.

Marrjen me qira të deponive ekzistuese në 5-6 pika kryesore

dhe krijimin e rezervave maksimale strategjike të naftës.

shqetësuese - kur bëhet fjalë për Serbinë, Kosovën dhe Kroacinë - është fjalori i papërgjegjshëm i elitave politike, që rrit tensionet, në vend se të shfrytëzohen mekanizmat ekzistues rajonalë ose të krijohen të rinj për komunikim dhe zgjidhje të problemeve. Thjesht, ekziston një prirje për të shkuar drejt rritjes së tensioneve - gjë që mund të jetë e rrezikshme, sepse edhe te qytetarët krijohet ndjenja e pasigurisë dhe frika se çfarë mund të ndodhë”, thotë Gjokiq për Exposenë. Qirjazi paralajmëron se një klimë e tillë tensionesh dhe mosbesimi mund të çojë në interpretime të gabuara nga pala tjetër, duke nxitur reagime të shpejta dhe të pakontrolluara. Kjo rrit rrezikun e përshkallëzimit edhe pa një qëllim të

drejtpërdrejtë për konflikt - një situatë të cilën Qirjazi e përkufizon si “keqllogaritje”. “Këtë e kemi parë edhe në konfliktin e fundit midis Iranit, Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara, ku argumenti ishte se kemi prova që Irani do të sulmonte i pari, ndaj ne goditëm. Apo - edhe në rastin e Irakut - u tha se Saddam Husseini do të krijonte armë bërthamore dhe do t'i përdorte kundër aleatëve në rajon, ndaj ne do të veprojmë. Kjo është ajo spiralja e sigurisë dhe përshkallëzimi”, shpjegon Qirjazi. Në përgjigje të blerjes së raketave kineze, Bashkimi Evropian - ku Serbia synon të anëtarësohet - tha se vendi duhet të bëjë zgjedhje të qarta strategjike në rrugën e integritimit. Ndërkohë, NATO-ja, partnere e Serbisë, nuk iu përgjigj interesimit të Radios Evropa e Lirë për mënyrën se si e shih

bashkëpunimin e vazhdueshëm të Beogradit me Pekinin. Në muajin maj, aleanca perëndimore do të mbajë stërvitje të përbashkëta ushtarake me Serbinë në poligonin Borovac, pranë kufirit me Kosovën. Në një postim në rrjetet sociale, Komanda e Forcave të Përbashkëta të NATO-s në Napoli tha se stërvitja do të zhvillohet me ftesë të Serbisë. Sipas saj, ajo forcon bashkëpunimin praktik dhe mbështet stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Për Qirjazin, kjo dëshmon se Serbia ndjek strategjinë e “lojës me disa porta”. Nga njëra anë i hap derën Kinës për të rritur ndikimin në rajon, dhe nga ana tjetër bashkëpunon me Perëndimin për të krijuar një lloj varësie të ndërsjellë. “Kjo strategji ka qenë karakteristike edhe e ish-

Jugosllavisë me Titon, pasi mbante partneritete dhe aleanca me shumë aktorë të ndryshëm strategjikë, në mënyrë që të krijonte një varësi të këtyre superfuqive ndaj këtij vendi”, thotë Qirjazi. Sipas tij, kjo qasje i jep Serbisë më shumë hapësirë manovrimi dhe i vendos aktorët ndërkombëtarë në një pozitë më të ndërlikuar në rast të konfliktit të mundshëm. Gjokiq pajtohet, por vë në pah edhe një aspekt tjetër: “Një nga arsyt pse shumë vende sigurojnë armë nga Kina është se ato janë më të lira. Rasti i Serbisë është pak më specifik në aspektin gjeografik, sepse ajo ndodhet në Evropë dhe prej saj ka pritje të tjera”. “Unë, për shembull, merrem me Afrikën Perëndimore dhe e di se atje ka shumë vende që kanë marrëdhënie të shkëlqyera me

BE-në dhe, në të njëjtën kohë, sigurojnë armatim nga Kina, sepse është më i lirë”, thotë Gjokiq. Vuçiqi nuk zbuloi çmimin e raketave kineze CM-400AKG, të cilat mund të bartin deri në 200 kg material shpërthyes, por i përshkroi si “shumë të shtrenjta”. Sipas raportit të fundit të SIPRI-t, blerjet e armëve në Evropë janë rritur ndjeshëm, duke e bërë kontinentin rajonin më të madh importues - me një rritje prej 210 % midis periudhave 2016-2020 dhe 2021-2025. Shtetet e Bashkuara, në anën tjetër, kanë rritur dominimin në eksportet e armëve - me Kosovën një prej klientëve të shumtë të tyre. Zyrtarët e mbrojtjes së Kosovës theksojnë se blerjet e armëve bëhen ekskluzivisht nga aleatët e NATO-s.

Urime ndërkombëtare për Kurtin pas mandatit të ri qeverisës

PRISHTINË, 23 MARS - Me rastin e fitores në zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 28 dhjetor 2025, si dhe zgjedhjen për një mandat të ri në krye të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kryeministri Albin Kurti ka pranuar një mori urimesh.

Kancelari i Gjermanisë, Friedrich Merz, presidenti i Francës Emmanuel Macron, kryeministri i Republikës së Çekisë Andrej Babiš, kryeministri i Dukatit të Madh të Luksemburgut, Luc Frieden, ambasadori jorezident i Shtetit të Katarit, Jabor bin Ali Al

Dosari, janë në mesin e liderëve dhe përfaqësuesve të shteteve, udhëheqësve të institucioneve dhe organizatave të rëndësishme ndërkombëtare e rajonale, përfaqësuesve politikë, aktivistëve dhe veprimtarëve që kanë uruar kryeministrin

Kurti. Krahas vazhdimit dhe thellimit të bashkëpunimit me shtetet, institucionet dhe organizatat përkatëse, elemente thelbësore në urimet e pranuara nga kryeministri Kurti ishin mbështetja për integrimin euroatlantik,



reformat, luftimin e korrupsionit dhe forcimin e sundimit të ligjit.

EKSPERTËT PARALAJMËROJNË: PËRDORIMI I KOKAINËS NË KOSOVË PO DEL JASHTË KONTROLLIT

PRISHTINË, 23 MARS - Rritja e përdorimit të kokainës nga të rinjtë në Kosovë po shndërrohet në shqetësim gjithnjë e më serioz për shëndetin publik. Ekspertët paralajmërojnë se mosha e përdoruesve po bie, ndërsa rastet po shtohen edhe në zonat rurale. Në të njëjtën kohë, mungesa e një qendre të specializuar për rehabilitim po e vështirëson trajtimin afatgjatë të varësisë, duke lënë shumë të rinj pa mbështetjen e nevojshme për rikuperim të plotë. Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës mjekët po përballen me rritje të rasteve të varësisë nga kokaina, veçanërisht te të rinjtë. Në Klinikën e Psikiatrisë aktualisht janë të shtrirë tre pacientë, dy me varësi nga kokaina dhe një nga alkooli. Vetëm pak ditë më parë numri i tyre ishte më i lartë. Samire Gashi Braina, psikiatre,

tha se “aktualisht janë të shtrirë tre pacientë, përderisa para dy dite kanë qenë 5, mirëpo njëri e ka ndërprerë trajtimin për shkak se nuk ka mundur t'i tejkalojë krizat e apsinecës dhe tjetri për shkaqe të tjera ka qenë e pamundur ta vazhdoj trajtimin. Aktualisht janë tre pacientë të shtrirë. Dy janë të varur nga kokaina, njëri nga alkooli. Një pacient është i moshës 24-vjeçare është, abuzues i të gjitha substancave dhe në gjashtë muajt e fundit është vetëm me kokainë”. Një nga sfidat kryesore mbetet mungesa e një qendre të specializuar për rehabilitim. “Detoksimi është në repartin tonë, pastaj kalohet në stabilizim. Vlerësohet se a ka probleme të natyrës psikike, a ka ankth, elemente të psikozës dhe i jepet terapia adekuate. Pastaj hallka e fundit është rehabilitimi dhe rikuperimi për të cilën hallkë është mjaft e rëndësishme të dalë komplet



nga gjendja. Por, fatkeqësisht, nuk kemi qendër rehabilitimi”, shtoi ajo. Organizatat që punojnë në terren paralajmërojnë se përdorimi i kokainës po

përhapet me shpejtësi dhe nuk është më i kufizuar vetëm në zonat urbane. Nga organizata “Labyrinth” thonë se parandalimi është i pamjaftueshëm për shkak të

mungesës së programeve të qëndrueshme edukative në shkolla. “Ne dimë që njerëzit nuk besojnë në parandalim, por ne besojmë thellësisht në parandalim nëse e zbatojmë mirë. Deri më tani nuk ka një kurrikulë, ose një program gjithëkombëtar i cili mund të zbatohet në të gjitha shkollat. Pra, sot duhet të fillojnë programet që t'i shohim efektet pas pesë vjetëve”, thotë Safet Blakaj nga organizata “Labyrinth”. Në një përgjigje zyrtare Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se përmes Departamentit të Planifikimit Strategjik Shëndetësor është hartuar dhe miratuar “Plani i veprimit për realizimin e projektit: Qendra e Sëmundjeve të Varësisë”, i aprovuar më 18 shtator 2025. Megjithatë, Ministria e Shëndetësisë nuk ka dhënë një afat të saktë për funksionalizimin e kësaj qendre. (RTK)

AKK-ja FILLON PROJEKTIN PËR RINDËRTIMIN E INFORMACIONEVE KADASTRALE NË 24 ZONA



PRISHTINË, 23 MARS - Projekti shumë i rëndësishëm për Rindërtimin e Informacioneve Kadastrale, i implementuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka filluar në 24 zona kadastrale. Ky projekt ka për qëllim adresimin e mospërputhjeve ndërmjet gjendjes faktike në terren dhe të dhënave të evidentuara në Regjistrin e të Drejtave mbi Pronat e Paluajtshme. Në kuadër të tij do të realizohen procese të rëndësishme si: zyrtarizimi i transaksioneve

joformale, regjistrimi i trashëgimive, matja e gjendjes faktike të parcelave dhe ndërtesave, si dhe regjistrimi i të gjitha këtyre ndryshimeve në regjistrin kadastral. Zbatimi i këtij projekti do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e sistemit kadastral, saktësimin e të dhënave pronësore dhe forcimin e sigurisë juridike për qytetarët. “Duke pasur parasysh që kemi shumë prona që janë ende në emër të gjyshërve apo prindërve tanë tani më të

ndjerë, shumë prona të tjera për të cilat para shumë viteve janë realizuar shitblerje pa ndonjë transaksion zyrtar por vetëm me ‘shtrëngim duarsh’, ndryshime në kufi të parcelave të cilat janë realizuar në terren e që nuk janë evidentuar në kadastrë etj, është shumë që banorët e këtyre tre zonave kadastrale t'i përgjigjen masivisht këtij projekti shtuar kësaj benefitin që i gjithë procesi realizohet pa pagesë për qytetarët”, është bërë me dije në njoftimin për medie.

Fillojnë punimet për renovimin e lapidarit të dëshmorëve dhe martirëve në Llukë të Epërme

Deçan, 23 mars - Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se në vigjilje të 24 marsit, kanë filluar punimet për renovimin e Lapidarit të Dëshmorëve dhe Martirëve në fshatin Llukë e

Epërme. “Ky vend përkujtimi mban gjallë kujtimin për sakrificën dhe heroizmin e atyre që dhanë jetën për lirinë tonë. Përkujdesja dhe mirëmbajtja e këtyre lapidarëve është detyrim i

yni, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje të përhershme. Lavdi të përjetshme dëshmorëve dhe martirëve të kombit”, ka thënë kryetari Ramosaj. I pranishëm në këtë ngjarje

ishte edhe kryesuesi i Asamblesë së Kuvendit Komunal të Deçanit, Hajdar Sutaj, drejtorë komunalë, veteranë të UÇK-së dhe banorë të fshatit Llukë e Epërme.



Edmond Hajrizi emërohet zëvendës-president i Organizatës Evropiane për Cilësi

PRISHTINË, 23 MARS - Edmond Hajrizi, themelues dhe president i Quality Kosovo, vizionar i UBT Smart City dhe rektor i UBT-së, është emëruar zëvendës-president i Organizatës Evropiane për Cilësi (EOQ).

Hajrizi është një figurë e njohur në Kosovë dhe në Evropë në fushën e akademisë dhe biznesit, i dalluar për leadershipin

dhe inovacionin e tij. Ai është anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe profesor universiteti.

Gjithashtu, është vlerësuar me çmime të shumta si “Lider Universitar i Vitit” dhe “Profesori Sipërmarrës i Vitit”.

Po ashtu, ka fituar çmimin prestigjioz “European Quality Leader of the Year”.

Vitin e kaluar ka marrë edhe një

çmim nga presidenti i Austrisë për kontributin e tij. Në rolin e tij të ri në EOQ, Hajrizi do të kontribuojë në formësimin e strategjive evropiane për menaxhimin e cilësisë, praktikat e qëndrueshme të organizatave dhe inovacionin, duke forcuar pozitën e Kosovës në hartën profesionale evropiane. “Jam thellësisht i nderuar që shërbej si zëvendës-president i

Organizatës Evropiane për Cilësi. Ky rol më lejon ta sjell ekspertizën e Kosovës në skenën evropiane dhe të promovoj ekselencën, inovacionin dhe cilësinë në organizata në të gjithë Evropën”, u shpreh Hajrizi.

Organizata Evropiane për Cilësi është një platformë kryesore për profesionistë dhe institucione, e dedikuar për avancimin e



menaxhimit të cilësisë, inovacionit dhe përmirësimit të vazhdueshëm në të gjithë Evropën.

KOMISIONI PËR BUXHET NIS PUNËN ME PRIORITETET STRATEGJIKE PËR PROKURORITË

PRISHTINË, 23 MARS - Komisioni për Buxhet, Financa dhe Administrimin e Prokurorive, në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prof. ass. dr. Dardan Vuniqi, ka mbajtur takimin e tij të parë, pas themelimit, në të cilin janë trajtuar çështje me rëndësi thelbësore që ndërlidhen me organizimin institucional, strukturimin funksional dhe ushtrimin efektiv të kompetencave të tij ligjore.

Në takim mori pjesë përbërja e re e anëtarëve të këtij komisioni: Sebahate Sinani (Prokuroria e Apelit) dhe Ersan Qavolli (Prokuroria Themelore në Pejë), si dhe Koordinatori i Komisioneve të Përhershme në KPK, Besim Kusari, udhëheqësi i

Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në SKPK, Nexhat Haziri dhe sekretarja e Komisionit, Diellza Bajrami.

Gjatë këtij takimi anëtarët e Komisionit kanë zhvilluar shqyrtim dhe diskutim substancial lidhur me prioritetet strategjike për periudhën në vijim, me fokus të veçantë në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë buxhetor, menaxhimin racional dhe transparent të burimeve financiare, si dhe avancimin e praktikave të administrimit të prokurorive në përputhje me standardet bashkëkohore të menaxhimit publik. Në këtë kontekst, është vënë theks i posaçëm edhe në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në trajtimin dhe



menaxhimin e lëndëve prokuroriale, përmes optimizimit të proceseve administrative dhe përmirësimit të mekanizmave mbikëqyrës. Komisioni, në ushtrim të mandatit të tij, është pajtuar për

inicimin e procedurave për hartimin dhe miratimin e Planit të Punës si një akt programor dhe udhëzues normativ, i cili do t'i përcaktojë objektivat konkrete, afatet kohore, indikatorët e performancës dhe përgjegjësitë

institucionale, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.


Në kuadër të diskutimeve është theksuar rëndësia e respektimit të parimeve të transparencës, llogaridhënies institucionale dhe sundimit të ligjit, si dhe nevoja për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim të garantimit të një sistemi prokurorial funksional, të pavarur dhe efikas në Republikën e Kosovës.

Komisioni ka njoftuar se do ta vazhdojë angazhimin e tij, me synim përmbushjen e plotë të mandatit kushtetues dhe ligjor, si dhe realizimin e objektivave të përcaktuara përmes akteve normative dhe politikave institucionale në fuqi.

VDIQ E DYSHUARA PËR VRASJEN E DYFISHTË NË PODUJEVË

PODUJEVË, 23 MARS - Autoritetet në Kosovë kanë bërë me dije të hënën se kanë vdekur dy gratë të cilat kanë qenë në gjendje të rëndë shëndetësore pas plagëve nga të shtënat me armë zjarri në fshatin Majac të Podujevës. Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se ka vdekur gruaja 31-vjeçare, e cila raportohet të jetë e dyshuar për kryerjen e dy vrasjeve të tjera më 22 mars.

Të hënën është konfirmuar vdekja e gruas 73-vjeçare, e cila kishte plagë të rënda, ndërsa



vdekja e një burri - trupi i të cilit është gjendur në një makinë - është konfirmuar një ditë më

parë. “Betimi për Drejtësi”, media e specializuar në fushën e

drejtësisë, ka raportuar se 31-vjeçarja është e dyshuar për vrasje dhe vetëvrasje. Sipas këtij mediumi, burri i vrarë dyshohet të ketë qenë i dashuri i saj.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka bërë me dije se hetimet për rastin po vazhdojnë, meqë motivet janë ende të panjohura për autoritetet. Në komunikatën për medie Prokuroria ka bërë me dije se autoritetet kanë sekuestruar një armë zjarri dhe disa gëzhjoja si dhe disa prova të tjera materiale relevante në vendin e ngjarjes. Policia e Kosovës ka bërë me dije

në raportin e saj ditor se më 22 mars e ka gjetur të vdekur një burrë në një makinë në të njëjtin fshat, ndërsa brenda në shtëpi janë gjetur dy gra me plagë të rënda.

Në javën që lamë pas janë regjistruar tre persona të tjerë të vdekur si pasojë e të shtënave me armë zjarri: një në Podujevë, një në Klinë dhe një në Gjakovë. Mijëra armë zjarri pa leje llogaritet të jenë në duart e qytetarëve të Kosovës. Ekspertët argumentojnë se është i nevojshëm konfiskimi i tyre me qëllim që të ulët numri i incidenteve të armatosura.

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes certifikon liderët e ardhshëm të FSK-së


Prishtinë, 23 mars - Në kuadër të zhvillimit profesional dhe ngritjes së kapaciteteve udhëheqëse, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes ka përfunduar me sukses certifikimi i dy kurseve të rëndësishme: Kursi për Lider të Avancuar “Gjenerata 17-2026” dhe Kursi për Lider Luftarak “Gjenerata 24 - 2026”. Këto kurse përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në

përgatitjen e kuadrove për përballimin e sfidave bashkëkohore, duke forcuar aftësitë e leadershipit, vendimarrjes dhe menaxhimit në situata komplekse operacionale dhe taktike.

Gjatë realizimit të tyre pjesëmarrësit kaluan nëpër një proces intensiv trajnimi, duke zhvilluar aftësi praktike dhe teorike të nevojshme për

udhëheqje efektive në çdo nivel të përgjegjësisë. Përmes këtij certifikimi pjesëmarrësit dëshmuuan përkushtim, profesionalizëm dhe gatishmëri për të marrë përgjegjësi më të larta në shërbim të misionit.

KDS ka njoftuar se mbetet e përkushtuar në zhvillimin e liderëve të aftë, të disiplinuar dhe të përgatitur për sfidat e së ardhmes.



SHAHINI: MBI 50 % JASHTË TREGUT TË PUNËS NË KOSOVË, POLITIKAT SHTETËRORE PO E ÇOJNË EKONOMINË DREJT STAGNIMIT

PRISHTINË, 23 MARS - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, duke iu referuar të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ka theksuar se mbi 50 % e popullsisë në moshë pune është jashtë tregut të punës në Kosovë. Sipas tij, politikat shtetërore janë duke e çuar ekonominë drejt stagnimit. “Të dhënat e fundit nga Agjencia e Statistikave e Kosovës nuk lënë vend për interpretime: mbi 51 % e popullsisë në moshë pune në Kosovë është jashtë tregut të punës - joaktiv. Kjo nuk është vetëm statistikë shqetësuese, po dëshmi e qartë e dështimit të politikave ekonomike dhe sociale ndër vite. Me një papunësi prej 13.9 % dhe qindra mijëra qytetarë joaktivë e numerikisht rreth 550 mijë,

Kosova po humb potencialin e saj më të madh - kapitalin njerëzor. Në vend të një ekonomie dinamike dhe konkurruese, po krijohet një model i varësisë nga remitencat dhe konsumi, pa bazë të fortë prodhuese”, ka thënë Shahini. Sipas tij, kjo situatë është pasojë e mungesës së strategjisë së qartë për punësim dhe zhvillim ekonomik. “Institucionet kanë dështuar të krijojnë politika efektive që lidhin arsimin me tregun e punës. Si rezultat kemi një paradoks të rrezikshëm: nga njëra anë papunësi të lartë, nga ana tjetër mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar për bizneset. Edhe më alarmuese është gjendja e grave në tregun e punës, ku mbi 65 % mbeten jashtë aktivitetit ekonomik. Kjo nuk është vetëm çështje



ekonomike, por tregues i një pabarazie të thellë dhe i mungesës së vullnetit institucional

për ta ndryshuar këtë realitet. Nëse mbi gjysma e popullsisë nuk kontribuon në ekonomi, atëherë

nuk mund të flasim për zhvillim, por për stagnim të vazhdueshëm. Përgjegjësia është e qartë dhe nuk mund të shpërndahet”, është shprehur ai. Shahini ka theksuar se qeveria dhe institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin urgjentisht masa konkrete, si politika aktive dhe të matshme për punësim, mbështetje reale për sektorin privat, reforma të thella në arsim dhe aftësi profesional, programe të targetuara për aktivizimin e grave dhe të rinjve. “Çdo vonesë e mëtejshme do ta thellojë krizën dhe do ta rrisë koston sociale dhe ekonomike për vendin. Kosova nuk ka problem me mungesë potenciali. Ka problem me mungesë veprimi. Ky është dështim që duhet pranuar dhe korrigjuar urgjentisht”, ka thënë Shahini.

ASK-ja: SHKALLA E PAPUNËSISË NË VITIN 2024 ISHTE 13.9 %

EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar raportin tematik për “Të dhënat e Tregut të Punës sipas Komunave”, të dhëna këto të dala nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos) 2024. Raporti “Të dhënat e tregut të punës sipas komunave” ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të treguesve të tregut të punës në nivel komune. Analiza përfshin të dhëna mbi popullsinë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe tipit të vendbanimit, si dhe mbi popullsinë e moshës 15-64 vjeç sipas statusit të aktivitetit ekonomik. Në mënyrë të veçantë publikimi paraqet të dhëna për personat e punësuar, të papunësuar dhe popullsinë ekonomiksht joaktive; shpërndarjen sipas gjinisë, grupmoshave, nivelit të arsimit,



profesionit dhe të aktiviteve ekonomike; statusin në punë, vendin e punës dhe tipin e vendbanimit; orët e punës gjatë javës referuese para regjistrimit; shpërndarjen territoriale të treguesve sipas komunave. Gjithashtu, publikimi përfshin analiza mbi strukturën e punësimit sipas aktiviteve ekonomike, profesioneve dhe përkatësisë etnike, si dhe të dhëna mbi

papunësinë sipas gjinisë, grupmoshave, nivelit të arsimit të përfunduar dhe arsyeve kryesore të joaktivitetit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe pjesëmarrjes në tregun e punës të personave me vështirësi afatgjatë. Sipas Rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024, shkalla e papunësisë në Kosovë ishte 13,9 %.

Derisa rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1 063 687) ishin popullsi në moshë pune; Persona aktivë ishin 514 791; Persona joaktivë ishin 548 896; Persona të punësuar ishin 443 364; dhe Persona të papunësuar ishin 71 427. Shkalla e joaktivitetit mbetet një nga sfidat kryesore të tregut të punës në Kosovë me 51,6 %. Kjo dukuri është veçanërisht e theksuar te femrat, ku shkalla e joaktivitetit është 65,4 %, krahasuar me 37,8 % te meshkujt.

Tregtia, arsimi dhe shëndetësia prijnë me punësim te femrat

Sektorët kryesorë ekonomikë që dominojnë punësimin ishin: tregtia 19,7 %, prodhimi 12,7 %, ndërtimtaria 9,6 %, arsimi 8,5 % dhe administrata publike dhe mbrojtja 8,2 %. Femrat ishin të punësuar, kryesisht në sektorët e tregtisë,


arsimit dhe kujdesit shëndetësor me 48,9 % të tyre. Ndërsa meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, prodhimit, ndërtimtarisë, administratës publike dhe mbrojtjes, në aktivitetet e akomodimit dhe shërbimeve me 63,2 %. Dallimet në rezultatet e treguesve të punësimit dhe papunësisë ndërmjet Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024) dhe Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) janë të pritshme dhe burojnë nga metodologjitë e ndryshme të mbledhjes së të dhënave, periodhat e referencës, përkufizimet statistikore të përdorura etj. Për këtë arsye Anketa e Fuqisë Punëtore konsiderohet burimi kryesor për statistikën e tregut të punës. Ndërkohë të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë (ReKos 2024) shërbejnë si burim plotësues, duke ofruar mundësi për analiza më strukturore dhe territoriale veçanërisht në nivel komunal dhe për grupe të ndryshme të popullsisë.

Rreziku për rritje çmimesh në Kosovë: Çfarë do të bëjë qeveria?

Prishtinë, 23 mars - Tregu i Kosovës është shumë i ekspozuar ndaj ndryshimeve të çmimeve apo situatave sikurse ajo në Iran, thotë ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari - Lila, prandaj vendosja e marzhës së fitimit për produkte të naftës, sipas saj, i ka parandaluar manipulimit me çmime. Në podkastin e Radios Evropa e Lirë “5 Pyetje”, ministrja tregoi, gjithashtu, pse ndryshuan çmimet në disa pika të karburanteve edhe pas marrjes së këtij vendimi. “Ka ndryshim të çmimit sepse marzha është e përcaktuar mbi çmimin e

importit dhe nuk është fikse, që të themi çmimi është statik”. Sipas saj, çmimi i naftës dhe derivateve të tjera në pika të karburanteve ndryshon varësisht si është çmimi i importit, por ky ndryshim i çmimit për konsumatorët nuk mund të jetë më i lartë se 12 centë për litër për blerësit me pakicë dhe 2 centë për litër për blerësit me shumicë. Sa iu përket rezervave të produkteve të naftës, ajo theksoi se Kosova qëndron në situatën e njëjtë siç ishte para se Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli t'i nisin sulmet në Iran dhe nuk ka nevojë për panik nga qytetarët.

Lidhur me mundësinë e rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore, Kusari-Lila tha se situata është e menaxhueshme teksa po punohet në Ligjin për vendosjen e çmimeve tavan në produktet esenciale. Ajo thotë se ky ligj është “masa e parë dhe shumë e nevojshme për t'i mbrojtur qytetarët që janë me pagë minimale apo pjesë të skemave sociale”. Produktet të cilave mund t'u vendoset çmimi tavan janë: mielli, qumështi, vaji, vezët, ushqimet për fëmijë e tjera. Megjithatë, ministrja thekson se mbetet të shihet se a do të ketë kuvend funksional për ta



miratuar këtë ligj.

Nëse Ligji për çmimet tavan mbetet pa u miratuar, Kusari-Lila tha se Inspektorati i Tregut do ta vazhdojë monitorimin e çmimeve

nëse ka abuzime nga tregtarët dhe se qeveria do të punojë për ta përkrahur prodhimin vendor që të mos reflektohet rritja e çmimeve nga jashtë.

AMERIKA A E KA NDIHMUAR KOSOVËN NË LUFTËN KUNDËR SERBISË PUSHTUESE, APO E KA ÇLIRUAR KOSOVËN NGA SERBIA PUSHTUESE



Ismet SYLEJMANI

Pas fillimit të bombardimeve të Iranit, nga aleati ynë SHBA dhe aleatit të Saj e aleatit tonë gjithashtu Izraelit, ndër shqiptarët në përgjithësi e në rrjetet sociale në veçanti, ka filluar një debat, në të cilin ka zëra që janë kundër bombardimeve të SHBA-së dhe Izraelit!

Ata shqiptar që mendojnë se Amerika e ka ndihmuar Kosovën në luftën kundër Serbise pushtuese, ata janë kundër bombardimit nga Amerika në Iran!

Pra këta shqiptar që rolin e Amerikës e quajnë ndihmë, aleatin e Amerikës në bombardimet mbi Iran, Izraelin dhe Natanjahun e quajnë shtet dhe Kryeministër kriminel!

Ata shqiptar që mendojnë se Amerika e ka çliruar Kosovën nga Serbia pushtuese, ata janë pro bombardimit të Iranit nga Amerika dhe Izraeli!

Pra këta shqiptar që rolin e Amerikes e quajnë çlirimtar të Kosovës, mendojnë se Amerika dhe Izraeli kanë të drejtë që bashkë me Izraelin e bombardojnë Iranin!

Por në thelb, roli i superaleatit të popullit dhe kombit shqiptar, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të saj në NATO gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kosovë (1998–1999) ishte vendimtar për përfundimin e konfliktit dhe largimin e forcave pushtuese serbe nga Kosova!

A e ka ndihmuar Amerika Kosovën?, gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër Serbisë pushtuese!

Po, pa dyshim dhe pa as më të voglën dilemë se e ka ndihmuar Amerika Kosovën në luftën kundër Serbisë pushtuese!

Shtete e Bashkuara të Amerikës i mbështeti politikisht kërkesat e shqiptarëve të Kosovës në

luftë kundër Serbisë pushtuese!

Shtetet e Bashkuara të Amerikës u angazhuan diplomatikisht në përpjekje për zgjidhje paqësore të pozitës së Kosovës gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë! Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin faktori kyç në vendimmarrjen historike për Kosovën, për ndërhyrje ushtarake, bombardimin e Serbisë pushtuese!

A e ka “çliruar” Amerika Kosovën?, gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër Serbisë pushtuese!

Ndërhyrja ushtarake e aleancës së NATO-s, me rol dominues e absolut të top aleatit të popullit shqiptar SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS përmes fushatës ajrore në vitin 1999 kundër Serbisë pushtuese ishte vendimtar për largimin e Serbisë pushtuese dhe çlirimin e Kosovës!

Ishte SHBA ajo që e detyroi Aleancën e NATO-s, të fillonte bombardimet në tërë teritorin e Serbisë pushtuese dhe mbi forcat e saj ushtarako-policore në Kosovë!

Bombardimi i Serbisë pushtuese, nga ana e 751 avionëve ushtarak të SHBA-së dhe të tjerë të Aleancës së NATO-s, ndërpreu dhunën dhe spastrimin etnik në Kosovë!

Bombardimi i Serbisë pushtuese, nga ana e 751 avionëve ushtarak të SHBA-së dhe të tjerë të shteteve të Aleancës së NATO-s i detyroi përfundimisht forcat pushtuese ushtarako-policore serbe dhe tërë aparatit pushtues e represiv që kishin shkaktuar masakra, terror, dhunë e gjenocid që të tërhiqeshin me disfata të mëdha dhe me turp nga Kosova!

Bombardimi i Serbisë pushtuese, nga ana e 751 avionëve ushtarak të SHBA-së dhe të tjerë të shteteve të Aleances se NATO-s, ishte ndërhyrja vendimtare nga ajri dhe bombardimi si akt, që çoi në çlirimin definitiv të Kosovës nga Serbia pushtuese! Është e rëndësishme të theksohet se lufta e armatosur çlirimtare e popullit shqiptar të Kosovës dhe veprimtaria liridashëse luftarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës



dhe gjaku i derdhur për liri i Heronjëve dhe Dëshmorëve të Kombit, luajtën rol të rëndësishëm në terren, dhe pa këtë rezistencë aktive, ndërhyrja ushtarake bombarduese e SHBA-së dhe e Aleancës ndërkombëtare, nuk do të kishte ardhur në të njëjtën nuk do të ishte e çliruar e lirë dhe e pavaruar Kosova!

Prandaj të gjithë duhet ta dijmë, ta pranojmë dhe ta themi hapur, pa hezitim dhe me zë të lartë kudo e para

kujtedo, me nderim e me respekt se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në bashkëpunim me Aleancen ushtarake veriatlantike NATO, luajti rol vendimtar e crucial në çlirimin e Kosovës nga sundimi shekullor i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët, përmes ndërhyrjes ushtarake të vitit 1999!

Çlirimi ishte edhe rezultat i rezistencës së popullit shqiptar të Kosovës dhe luftës së armatosur çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të


Kosovës!

Çdo shqiptar i cilës do gjini, i cilës do moshë dhe kudo që është brenda e jashtë Atdhut, kudo nëpër botë duhet të jetë me aleatin e Kombit shqiptar Amerikën!

Kushdo që është aleat i aleatit tonë, është edhe aleat i yni!

Prandaj jemi me çlirimtarin tonë nga Serbia pushtuese dhe me aleatin e saj e tonin Izraelin!

Në çdo seknd, orë, dite muaj e vit, në çdo hap me top aleatin tonë Amerikën!



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Drita, lidere në Superligën e Kosovës në futboll

PRISHTINË, 23 MARS - Kampionia në fuqi, Drita, ka triumfuar në derbin lokal ndaj Gjilanit me rezultat minimal 1:0 në kuadër të javës së 26 në Albi Mall Superligë, duke kryesuar tashmë e vetme në renditje. Ndeshja e zhvilluar në terrenin sintetik në Gjilan është vendosur në fundin e pjesës së

parë, kur Veton Tusha ka realizuar me gjuajtje me kokë në minutën e 44-t, pas një asistimi të Kristal Abazajt. Me këtë fitore Drita ka krijuar epërsi prej tri pikësh ndaj ndjekësit më të afërt, Ballkanit, që në këtë xhiro është mposhtur nga Prishtina. Gjilani ndërkohë mbetet në

pozitën e pestë me 39 pikë. Fitore të rëndësishme ka realizuar edhe Malisheva, e cila në stadiumin "Liman Gegaj" e ka mposhtur Llabin me rezultat 2:0, duke u rikthyer te suksesi pas dy humbjeve radhazi. Kjo fitore e ngjit Malishevën në vendin e katërt me 40 pikë, ndërsa Llapi mbetet në pozitën

e tetë me 29 pikë. Ndërkohë, në Klinë, Dukagjini dhe Prishtina e Re kanë ndarë pikët në barazim 1:1. Pas këtij barazimi Prishtina e Re mbetet në vendin e fundit me 24 pikë, ndërsa Dukagjini renditet i gjashti me 34 pikë. Në kuadër të xhiros së 26 Ferizaj ka mposhtur Drenicën 1:0. Me



këtë fitore Ferizaj renditet në pozitën e shtatë me 32 pikë, ndërsa Drenica renditet e nënta me 29 pikë.

FODA PARA NDESHJES ME SLOVAKINË: MUND TA SHKRUAJMË HISTORINË

PRISHTINË, 23 MARS - Selektori i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, ka shprehur optimizëm para ndeshjes me Sllovakinë. Trajneri gjerman në një konferencë për medie ka folur për duelin e së enjtes, i vlefshëm për gjysmëfinalen e "play-off"-it të Botërorit 2026, duke thënë se Kosova mund ta shkruajë historinë. "E dimë se çfarë na pret. Është një presion i lartë, por duam ta shndërrojmë në energji pozitive. Kemi treguar se në këso situata dimë ta

menaxhojmë emocionin dhe situatën. Është një mundësi e mirë, mundësi që nuk vjen shpesh. E dimë se nëse i fitojmë këto dy ndeshje shkojmë në Botëror. Do të japim gjithçka nga vetja dhe mund ta shkruajmë historinë", ka thënë Foda, duke shtuar se faza e grupeve ka qenë e vështirë për Kombëtaren e Kosovës. "Faza e grupeve ka qenë e vështirë. Ka qenë ëndërr për ne ta kalojmë fazën e grupeve. Synimi ynë ka qenë vendi i dytë dhe aty



përfunduam. Tash jemi në 'play-off' dhe mund ta shkruajmë historinë. I kemi

dy ndeshjet e radhës. Duhet ta kemi parasysh se Sllovakia e ka mundur Gjermaninë


dhe ka cilësi. I kemi dy ndeshjet e fundit dhe do të bëjmë çmos që Kosovën ta përfaqësojmë denjësisht. Lojtarët janë të motivuar dhe kemi ekip me një shpirt luftarak", ka thënë Foda. Më tutje Foda ka treguar se si është zhvilluar Kombëtarja e Kosovës në futboll. "Prej se jam trajner këtu kjo skuadër është zhvilluar tutje. E kemi këtë ndjenjë dhe eufori momentale. Për ne është me rëndësi që të enjten ekipi të bëjë çmos që të fitojmë", është shprehur Foda.

KRYEZIU: VAZHDIMËSI DHE PËRKUSHTIM PËR OBJEKTIVAT E KOSOVËS U21

PRISHTINË, 23 MARS - Përzgjedhësi i Kombëtares U21 të Kosovës, Hekuran Kryeziu, ka folur për fagen zyrtare të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) lidhur me rolin e tij të ri dhe objektivat e ekipit në këtë cikël kualifikues, duke theksuar përkushtimin maksimal për vazhdimësinë e rezultateve pozitive. Kryeziu ka thënë se kalimi nga fusha në një rol teknik ka qenë një proces i menduar prej kohësh, duke nisur që nga periudha kur ishte futbollist aktiv. "Gjatë karrierës si lojtar gjithmonë kam analizuar vendimet e trajnerëve qoftë në aspektin taktik, sistemin e lojës apo formacionin. Ka qenë diçka që më ka interesuar

vazhdimisht dhe pas përfundimit të karrierës ishte dëshira ime që të vazhdoj të kontribuoj në futboll edhe jashtë fushës", ka thënë ai. Kryeziu e ka cilësuar hap të rëndësishëm angazhimin në kuadër të Kombëtares U21, duke falënderuar ish-përzgjedhësin Afrim Tovërlani dhe gjithë stafin për bashkëpunimin. Kryeziu veçoi edhe grumbullimin e fundit në nëntor ku, sipas tij, ekipi ka treguar atmosferë shumë të mirë dhe unitet të lartë brenda grupit. Duke folur për kualifikimet për Euro 2027, ai ka theksuar se Kombëtarja U21 ndodhet në një proces të rëndësishëm dhe në një

rugëtim që ka nisur me sukses. "Kemi filluar këtë cikël që nga shtatori dhe kemi pasur paraqitje të mira. Baza e lojtarëve ka mbetur pothuajse e njëjtë në pesë ndeshjet e fundit dhe kjo na ka dhënë stabilitet në lojë dhe rezultate. E dimë që është një rrugë e vështirë, por synimi ynë është të përgatitemi maksimalisht dhe ta japim maksimumin në çdo ndeshje", është shprehur Kryeziu. Ai ka bërë me dije se në muajt e fundit stafi teknik ka punuar intensivisht në analizën e lojtarëve, jo vetëm të kundërshtarëve, por edhe të futbollistëve të Kombëtares. Megjithatë ekipi përballlet me disa mungesa në këtë



grumbullim, Kryeziu ka theksuar se besimi te lojtarët e ftuar është i plotë. "Për ne është shumë e rëndësishme që ata lojtarë që janë pjesë e

grumbullimit ta japin maksimumin. Dyert e Kombëtares janë të hapura për të gjithë dhe përzgjedhja bëhet në bazë të performancave në klubet e tyre", ka thënë ai, duke përmendur edhe prurjet e reja si Arjol Bllaca nga FC Prishtina, Fuad Ajvazi nga Llapi dhe portieri Art Miftari. Në fund, Kryeziu ka thënë se fokusi i ekipit mbetet te ndeshjet e radhës, duke nisur me përballjen ndaj Rumanisë. "Është mirë të ëndërrosh dhe t'i ndjekësh ëndrrat, por tash i kemi dy ndeshje shumë të vështira kundër Rumanisë dhe Spanjës. Për momentin fokusi është 100 për qind për ndeshjen me Rumaninë", ka thënë Kryeziu.

City fiton Kupën e Ligës, Arsenali vazhdon agjërimitin e trofeve

LONDËR, 23 MARS - Manchester City ka fituar për herë të nëntë Kupën e Ligës së Anglisë apo Carabap Cup, pasi e ka mposhtur në finale liderin e tabelës së Premierligës, Arsenalin. Në "Wembley", City ka fituar 2-0 me dy gola të

shënuar në pjesën e dytë, pas një pjese të parë të mërzitshme nga të dyja palët. Nico O'Reilly ka shkëlqyer në këtë përballje me dy gola të shënuar. Së pari anglezi i ri ka shënuar në minutën e 60, pas një gabimi të rëndë nga Kepa Arrizabalaga, i

cili nuk ka mundur ta mbajë topin në duar, para se ai të shkonte tek anglezi, që e gjeti veten më së miri në atë çast. Golin e dytë O'Reilly e ka shënuar vetëm katër minuta më vonë, pas një asistimi nga Matheus Nunes. 21-vjeçari ka

shënuar me kokë, pothuajse një rikrijim i golit të parë. Ky triumf ia ka sjellë City trofeun e 19 nën drejtimin e Pep Guardiolës, i cili është shumë i mirëpritur pas eliminimit nga Liga e Kampionëve prej Real Madridit në mesjavë. Arsenali vazhdon



agjërimitin pa trofe për gjashtë vjet me radhë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja
Ministry of Environment Spatial and Planning

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Plotësim Ndryshimin e Kushteve Ndërtimore nga EV WIND PARK SH.P.K. me nr. të protokolit 9090/25 të datës 22.12.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet projekti " NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " me infrastrukturën përcjellëse që ndodhen në Zonën Kadastrale Zatriq me numër të parcelave:
01119-1, 01112-0 dhe 00530-1, 00544-0 në Komunën e Rahovecit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Plotësim Ndryshimin e Kushteve Ndërtimore për projektin " NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji me erë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.01.04.2026 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:

Plotësim Ndryshimi I Kushteve Ndërtimore të propozuara: EV WIND PARK SH.P.K. projekti-" NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " Z.K. Zatriq - Komuna e Rahovecit"

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 7, 8 dhe Kullosë e klasës 5 dhe 6, Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli

b. Vija rregulluese.	7.5 m' 27.5 m'
c. Vija c ndërtimit.	2.45 m' 10.11 m'

d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike 4.5 m'
9.72-18.69 m'

e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës. 4.5 m'
67.01-90.82 m'

f. Përqindja c sipërfaqes ndërtuesc bruto në proporcion me sipërfaqen c parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte 8.13 %

g. Përqindja c sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen c parcelës kadastrale. 76.91 %

h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. - %

i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. - %

j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve. 30

k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Struktura mbajtese beton-arme, konstruksioni i turbinave çelik. Mbulesa e nenstacionit me kulm te rrafshct te pashfrytezueshem me shtresa izoluese
--	--

l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐
Nuk aplikohet ☐

m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth?
Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:

n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:

OBAVEŠTAVAM

Moje suvlasnike: ÇAMIL (Jashar) JASHARI, LJATA (Nijazija) TAIRI, BAJRAM (Hasan) TELAKU, SAFET (Ashim) SADIKI, SEJBIT (Ashim) SADIKI, SADIK (Ashim) SADIKI, SAIT (Ashim) SADIKI, SABIT (Ashim) SADIKI, HANIFA SADIKI, NEXHMEDIN (Hasip) NEZIRI, AJRIJA MURTOVI rod.SADIKI, MUSTA (Ilijaz) META, PETRIT (Xhavit) DINA, BESNIK (Xhavit) DINA, AZEMKA (Beqir) BILIBANI, FARIJA (Beqir) AHMETI, HASAN (Amdì) RAKAJ i MESTAN (Harun) MESTANI kao zainteresovani kupci, Mi: SUNAJ (Sli) IDRIZI kao suvlasnik sa idelanim delom 1/48 i RAMEL (Raman) IDRIZI, sa idelanim delom 1/48, prodajemo u celosti naše suvlasničke delova susvojine, što obuhvata površinu od 234.375m2, na Kat-Parceli: P-71813068-05462-0 Katastarska Zona Prizren.

Ovim putem nudimo suvlasnicima ukoliko su zainteresovani za kupovinu naših suvlasničkih dela, da se javu u roku od 30 dana. Ujedno obaveštavamo da već imamo potencijalnog Kupca koji će u roku od 30 dana platiti kupoprodajnu cenu od 50.000,00 € za površinu od 234,375m2 od parcele P-71813068-05462-0, i to načinom uplate u gotovini /odjednom.

Kontakt telefon: 049739-947

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Euro Metal Company” SH.P.K. shpall të pavlefshme nr. E biznesit me nr. 70369886 të lëshuar nga MTI. Kosovës.
- Kristijan Pnishi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lule Osmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Xheva Çoqaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës filloore “Zenun Çoqaj” në Gjonaj Prizren.
- Patirot Jahaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Mazrek Prizren.
- Firma Lakeside Ag SH.P.K. me nr. Biznesi: 811284603 në Vermic, Prizren bënë zvogëlimin e kapitalit nga vlera 15,000,000 në vlerën 100, 000.
- Kjo iniciativë vjen si një shenjë vlerësimi dhe respekti për gratë, duke u ofruar atyre mundësi më të lehtë për t’u pajisur me patentë shoferi dhe për të fituar pavarësi në komunikacion.
- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës.
- Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.
- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.
- Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “BVL DOO”, Leshak, Leposaviq, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për pikën e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe gasit në Leshak, Komuna Leposaviq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.05.2026 në ora 11:00 në "Stana Baçanin" Lešak, K. Leposaviq, do të organizohet debat publik nga “BVL DOO”, Leshak, Leposaviq, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/2166524738?pwd=aJtauckjGTWwqBViEIFDw68ND03rzD.1>

Meeting ID: 216 652 4738

Passcode: 123123

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për pikën e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe gasit në Leshak, Komuna Leposaviq.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “2T Company”, Sh.p.k. Obiliq, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për qendrën për grumbullimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, në Z.K. Caravodicë, Komuna Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.05.2026 në ora 10:00 në Sh.F.M.U. ”Fazli Greiçevci” pn, Palaj, komuna Obiliq, do të organizohet debat publik nga “2T Company”, Sh.p.k. Obiliq në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “2T Company”, Sh.p.k. Obiliq, për qendrën për grumbullimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave tjera sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, në Z.K. Caravodicë, Komuna Obiliq.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

